



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Nr. Prot.

Tiranë, më

/12/2018

V E N D I M

Nr. 245, Datë 21/12/ 2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT “MBI
PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË E AKTIVITETIT
EKONOMIK DHE FINANCIAR”.

Për periudhën nga data 1.11.2016 deri më datën 31.8.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin rregullator në fuqi për periudhën e audituar 01.11.2016 - 31.8.2018 ka pasur devijime nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ përkatës.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit”, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit sipas programit të auditimit nr. 702/1 prot, datë 22.6.2018 për veprimtarinë nga data 01.11.2016 deri me datë 31.8.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

OPINIONI I AUDITUESIT:

1. Mbi dhënien e gradave.

Opinion i pa kualifikuar me theksim çështje¹ “Mbi zbatimin procedurave ligjore për dhënien e gradave”.

Baza për dhënien e opinionit për ligjshmërinë dhe përputhshmërinë janë ISSAI 4100.

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të shkaktuara nga dhënia e gabuar e gradave punonjësve të policisë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), konstatohet se ish Drejtori i Përgjithshëm, i ka “hapur rrugën” e marrjes së gradave më të larta nga punonjësit e policisë pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit, nëpërmjet emërimeve të punonjësve të policisë me gradë më të ulët, në funksione më të larta.

Punonjësi i policisë, që të ngrihet në funksion, duhet të ketë gradën përkatëse, e cila fitohet vetëm me konkurrim. Me marrjen e funksionit, punonjësi i policisë i është drejtuar gjykatës/gjykatave, duke kërkuar gradën më të lartë, me arsyetimin kryesisht “se e meriton përderisa kryen punën (nëpërmjet funksionit), ka vjetërsinë etj, dhe ky arsyetim ka funksionuar”.

Gjykatat përgjithësisht ju kanë dhënë gradën më të lartë punonjësve të policisë, të cilët janë ankuar.

Praktika e ndjekur nga DPPSH, është në kundërshtim me:

- nenin 50/2 të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 në të cilin është përcaktuar se” ... *Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit,*

- nenin 53/2 “Dhënia e gradës” të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 grada “Nënkomisar” deri “Drejtues i parë” jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji”, dhe

- nenin 54 në të cilin është përcaktuar se “... *Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi”.*

Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioritetëve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive.

Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse.”

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit u konstatua se gjatë vitit 2017, DPPSH ka operuar përmes letër-kredive (LC), për likuidimin e kontraktorëve të ndryshëm për blerjet e realizuara (investime dhe shpenzime operative), duke rritur shpenzimet publike të periudhës aktuale, kur këto investime do të realizohen dhe do të vihen në funksion vitet e ardhshme. Pagesa me LC është përdorur në tenderin me objekt “Ndërtimi i datacenter për sistemet e Policisë së Shtetit”, “Mirëmbajtje vjetore për sistemin AFIZ” dhe “Mbështetje Teknike për Sistemin Arsenal”, në shumën 131,838,593 lekë gjithsej. Përdorimi i LC nga institucioni, në masën e plotë të investimit, cenon parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të anualitetit, transparencës dhe besueshmërisë, të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pasi institucioni ka deklaruar investime/shpenzime të pa kryera si të realizuara për vitin 2017, ndërkohë që ato janë kryer/likuiduar pas vitit 2017.

1.1. Nga auditimi rezulton se asnjë nga investimet nuk është kontratë e rëndësishme së veçantë (për investime dhe shërbime), ose kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor, siç përcaktohet në pikën 147 të Udhëzimit të MF nr. 2, datë 06. 02. 2012

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, Audituesi duhet të shprehë një opinion të pakualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të njafueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pasi objekti për “Ndërtimin e datacenter për sistemet e Policisë së Shtetit” është planifikuar që në 2015 dhe fondet për realizimin e shërbimit janë planifikuar në buxhetin e 2017. Për programin “Mirëmbajtje vjetore për sistemin AFIS” dhe “Mirëmbajtje vjetore për sistemin Arsenal” janë kontrata të lidhura që nga vitet 2003 dhe në vitin 2017 është bërë rinovimi i kontratave për vazhdimin e mirëmbajtjes së sistemit dhe pagesa e shërbimit vazhdon të paguhet me LC.

1.2. Përdorimi i LC nga institucioni rrit koston financiare të tyre, pasi duhet të paguajë shpenzime shtesë në favor të bankave të nivelit të dytë. Kostoja shtesë e paguar nga institucioni për realizimin e pagesave me letër kredi për të tre shërbimet e përshkruara është në 673,283 lekë gjithsej.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 4-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të eliminohen praktikat e futjes së përdorimit të LC në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit, për të ruajtur parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të anualitetit, pasi përdorimi i LC në këto kushte ka si qëllim vetëm transferimin e fondeve tek kompanitë private për punë të pakryera në formë parapagimi, të cilat do të realizohen dhe finalizohen si mallra/shërbime në periudhat e ardhshme buxhetore.

1.2 LC të përdoren vetëm për kontrata të veçanta, ose për raste kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor, ku paradhënia mund të jetë deri në 10 për qind, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit, u konstatua se në raportet e monitorimit për 8 mujorët e vitit 2017 dhe 2018, institucioni ka paraqitur raportin sipas tabelave standarde të miratuara në Udhëzimin e MF nr. 22, datë 17.11.2016 dhe relacionin shpjegues për mospërputhjet ndaj parashikimeve të periudhës raportuese, por nuk është shprehur mbi masat korrigjuese që duhen ndërmarrë, në zbatim të udhëzimit kapitulli III, “Procedurat për procesin e monitorimit” pika 52.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 4-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Në përfundim të raportit të monitorimit për 8 mujorin e fundit të vitit, anëtarët e Ekipi Menaxhimit të Programeve (EMP) të shprehet mbi masat që duhet të merren për veprime korrigjuese në rast të mosrealizimit të planeve. Në rastet kur veprimet korrigjuese shkojnë përtej përgjegjësisë së anëtarëve të EMP, por brenda përgjegjësisë së anëtarëve të tjerë në institucion ose edhe jashtë, argumentet mbështetës të tyre, duhet të përfshihen si rekomandime në relacionin e raportit të performancës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër – shpenzimeve u konstatua se blerjet e realizuara për bileta transporti ajror, janë kryer me procedurë prokurimi të drejtpërdrejtë, gjatë gjithë periudhës objekt auditimi, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” me ndryshime etj., në të cilën është përcaktuar se “... nëse autoriteti kontraktor ka shpallur dy herë radhazi në sistemin elektronik të prokurimit procedurën me vlerë të vogël dhe kjo procedurë prokurimi është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës, atëherë autoriteti mund të vijojë me realizimin e procedurës së drejtpërdrejtë”. Blerja e shërbimit është realizuar nga Departamenti i Zyrës Qendrore të Interpolit Tiranë, me arsyetimin se kemi të bëjmë me bileta për rastet e ekstradimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Policisë të marra masat që në rastet e blerjes së shërbimeve “blerje bileta transporti ajror” nga operatorë ekonomik të zhvillohet me procedurën e prokurimit on line, duke bërë të mundur përzgjedhjen e ofertës më të mire dhe më efektive, me ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit. Nëse blerja klasifikohet sekret, DPPSH, t'i kërkojë/propozojë Ministrisë së Punëve të Brendshëm, nxjerrjen e një dispozite ligjore për mënyrën e realizimit të procedurës së blerjes të këtij shërbimi.

Në vazhdim

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve, u konstatua se për shërbimin e sigurimit të mjeteve motorike nga subjekti “I...”, nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, në kundërshtim me nenin 6 të kontratës nr. 6849/1, datë 05.12.2016 dhe nr. 5912/1, datë 05.12.2017, në të cilën është përcaktuar se: “... realizimi i shërbimit duhet bërë brenda 12 muajve”. DPPSH ka shkelur këtë pikë kontrate, duke bërë shtesë kontrate, për sigurimin e mjeteve të cilat kanë qenë të planifikuara për tu realizuar në kontratën e parë, e cila është shoqëruar më rritjen e kostos së shërbimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: DPPSH të marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, duke caktuar në cdo kontratë persona përgjegjës për monitorimin e saj.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike, në tenderët me objekt: “Lyerje dizajnim të mjeteve rrugore të Policisë së Shtetit” viti 2016, viti 2017 loti I dhe II, “Zgjerimi i kapaciteteve të sistemit të balistikës ARSENAL/Papillon” dhe “Marrje mjetes me qira operacionale për Policinë e Shtetit”, prokuruar viti 2017, u konstatuan parregullsi në:

-*Hartimin e Dokumenteve të Tenderit*, në vendosjen e Kritereve të Veçanta për Kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 46/3, VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 28, pika 2, 3,5/a, Dokumentet e Tenderit (DT), pika 2/2.3, germa c dhe g

-*Zhvillimin e procedurës së prokurimit* pasi KVO ka klasifikuar BOE “S...”, në kundërshtim me:

- Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar neni 53,

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 66/3,

-DT, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3/a,b etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik si organ që ka tagrin ligjor në përputhje me nenin 13, pika 2/a,g, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, në mënyrë që të bëhen përmirësime ligjore në VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 28, pika 3, duke përcaktuar në mënyrë eksplicite përveç vlerës maksimale dhe vlerën minimale të kontratës për “punë të ngjashme”, të shprehur në përqindje duke vendosur në këtë mënyrë kufij të qartë të vlerës së kontratës në përmbushje të kriterit për përvojën e mëparshme, të realizuar nga operatorët gjatë 3 viteve të fundit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike në tenderin me objekt “Blerje Materiale për analizat e ADN” konstatohet parregullsi në argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit e cila nuk është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 33, pika 2/b,

Përzgjedhja e procedurës së prokurimit nga AK referuar nenit 33, pika 2/b të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, si dhe baza ligjore neni 36, pika 2/b e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime nuk justifikon përzgjedhjen në rastin konkret, pasi kjo bazë ligjore lidhet me të drejtat ekskluzive. Ekzistenca e kushteve të mësipërme duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore. Në këto kushte, AK në asnjë nga rastet nuk vërteton ekzistencën e kushteve të sipërme ligjore,

Nga ana tjetër, blerja e materialeve për analizat e ADN nuk është rast emergjent, pasi nevoja për materiale të tilla në institucionin e Policisë është kërkesë e përhershme dhe nuk justifikon faktorin "emergjencë", për të cilën legjislacioni për prokurimin publik parashikon kryerjen e procedurës negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Për pasojë, përzgjedhja e procedurës "negocim pa shpallje" është bërë në mungesë të kushteve të nenit 33, pika 2/b të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve publike në tenderin me objekt "Pajisje për modernizimin e Laboratorit të Biologjisë ADN-së në Institutin e Policisë Shkencore" Loti I dhe II, konstatohet parregullsi në:

1. *Përzgjedhjen e procedurës së prokurimit* e cila nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 33/3, pika a, pika 2/b dhe neni 23/5.

Arsyet e përdorimit të kësaj procedure nga ana e AK janë argumentuar duke u bazuar në nenin 33, pika 2/b të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, nenin 33, pika 3/a, nenin 36, pika 2/b, ç VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar si dhe Shkresave nr. 7252/1, dhe nr. 7252/2, datë 16.10.2017 të Institutit të Policisë Shkencore. Referuar nenit 57, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, AK nuk ka argumentuar përzgjedhjen e procedurës së prokurimit pasi, është bazuar në dy kushte të ndryshme të situatave. Nga njëra anë kemi kushtin që lidhet me "të drejtat ekskluzive" dhe nga ana tjetër kemi rastin kur mallrat e kërkuara prodhohen vetëm për "qëllime kërkimi".

2. *Në hartimin e dokumenteve të tenderit (DT)* pasi vendosja e kritereve të veçanta nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar 23/5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Marrje mjetesh me qira operationale për Policinë e Shtetit", prokuruar **viti 2017**, konstatohet parregullsi në:

1. *Hartimin e dokumenteve të tenderit (DT)* pasi vendosja e kritereve të veçanta nuk është bërë në përputhje të plotë me: Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 dhe neni 46/3 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe Dokumentet e Tenderit (DT), pika 2.3, pika 6

2. *Zhvillimin e procedurës së prokurimit*, pasi KVO ka klasifikuar OE "T.." jo në përputhje me DT, pika 2, pika 2.3/ a, Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar neni 53/5

Dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 66/3.

Operatori duhet të ishte skualifikuar pasi nuk përmbush kriteret e veçanta dhe tenderi duhet të ishte anuluar në përputhje me nenin 24 të LPP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së tenderit me objekt "Ndërtimi I komisaritit special Renea", u konstatua se Kontraktori BOE "A..." fitues i tenderit nuk ka siguruar objektin me vlerë totale me emra të përbashkët të investitorit dhe Kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në datën e realizimit të plotë të ndërtimeve etj ... në kundërshtim me nenin 24 "Sigurimi" të kontratës lidhur midis palëve të përshkuara më lartë, për objektin "Ndërtim i Komisaritit Special Renea"

Tiranë, në të cilin është përcaktuar se ... *Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.*

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, të kërkojë nga mbikëqyrësi i punimeve subjekti “D...” sh.p.k. me përfaqësues ligjor z. N.V, që BOE “A...” fitues i tenderit, të bëjë menjëherë sigurimin e objektit me vlerë totale me emra të përbashkët të investitorit dhe Kontraktorit etj, në të kundërt, në zbatim të nenit 24 “Sigurimi”, të njoftoj autoritetin kontraktor, për të mbajtur qëndrim ndaj Kontraktorit, deri në anulimin e kontratës.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Ndërtim, rikonstruksion i objektit Komisariati nr. 6” Tiranë, me fond limit 188,202,443 lekë, i zhvilluar në vitin 2016 kanë paraqitur oferta dy OE ofertues, nga të cilët KVO ka skualifikuar OE “A..I..”. Nga verifikimi dokumentacionit, rezultoi se skualifikimi i tij është i drejtë.

KVO ka vlerësuar të saktë dokumentacionin tekniko ligjor kualifikues të OE “F...” dhe e ka klasifikuar pa rezerva në vend të parë.

Grupi i auditimit bëri verifikimin e dokumentacionit ligjor kualifikues të OE “F..” sh.p.k. i cili është shpallur fitues, në përfundim të të cilit rezultoi se ka mangësi në plotësimin “Kritereve të veçanta të kualifikimit” si mungesë mjetesh, mungesë autorizim prodhuesi për të gjithë pajisjet e jashtme dhe të brendshme që do të përdoren për ngrohjen dhe ftohjen etj.

Në këto kushte, kualifikimi i “F...” sh.p.k. bie ndesh me:

- nenin 66/3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... *komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe*

- DST në të cilat është përcaktuar se ... *Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim...*

KVO në kualifikimin/skualifikimin e OE ka mbajtur standard të dyfishtë pasi me të drejtë, për parregullsi të evidentuara në dokumentacionin ligjor - kualifikues, ka skualifikuar OE “A...I..”, por nuk ka ruajtur të njëjtin standard edhe me OE “F..”sh.p.k. oferta ekonomike e të cilit është 18,215,357 lekë më e lartë se sa oferta ekonomike e OE “A.. I..” sh.p.k.

Në këtë situatë, AK mbështetur në nenin 73 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duhet të anulonte procedurën dhe fillonte një procedurë të re prokurimi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dëmi ekonomik i shkaktuar është **729,238 lekë** gjithsej, si më poshtë:

1. Në llogaritjen e vleftës së preventivit për objektin “Ndërtim i Komisarariatit Special Renea” Tiranë, është parashikuar/përfshirë fond rezervë në zërin e punimeve “FV pemë dekorative” dhe për pajisje (kryesisht cisterna uji), në masën 5 për qind të vlerës së tyre,

ose 537,238 lekë gjithsej, kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit”.

Duke ju referuar manualit, konstatohet se mbi 95 për qind të çmimit e përbën blerja e “*pemë dekorative*”/(pajisje), dhe më pak se 5 për qind zëri “*të tjera*”, rezulton se janë parashikuar, e në vijim përfituar më tepër nga OE fitues “A...” sh.p.k. 537,238 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **537,238 lekë** gjithsej, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “A...” sh.p.k.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (Kontrata e punimeve, Akt kolaudimi dhe Situacioni Përfundimtar) të objektit “*Ndërtim dhe Rikonstruksion i Komisarariatit Special RENE A*”, Loti I me emërtim “*Sistemimet e Jashtme*” u konstatua se janë likuiduar, zërat nr. 21, nr. 22 “Dizinfektim + shpëlarje tubi” dhe “Marje analizash”, në kundërshtim me nenin 19 të kontratës, i cili i parashikon që këto zëra punimesh të kryhen me shpenzimet e vet kontraktorit, duke çuar në përfitimin e padrejtë të shumës 192,000 lekë nga OE “J...” sh.p.k.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **192,000 lekë** gjithsej, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “J...” sh.p.k.

Menjëherë

C. MBI BLERJEN/PËRDORIMIN PA EFEKTIVITET, EFICENSË DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE

C.1. Gjatë vitit 2014-2015 DPPSH i janë çelur fonde për blerjen e një sasive motoçikletash. Nevoja për blerjen e tyre është e argumentuar me amortizimin e motoçikletave ekzistuese dhe me qëllim pajisjen e strukturave të Policisë së Shtetit me mjete funksionale dhe në performancën e duhur për përmbushjen e detyrave institucionale ...

Tenderi është zhvilluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kurse dokumentacioni për këtë qëllim është përgatitur nga DPPSH.

Gjatë vitit 2014 është zhvilluar/realizuar procedura e prokurimit për blerjen e 122 motoçikletave me vlerë të kontratës së lidhur 70,506,240 lekë gjithsej (577,920 lekë/copa). DPPSH gjatë vitit 2015, në bazë të studimit të Drejtorisë së Drejtorisë së Rendit Publik në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike, ka zhvilluar/realizuar procedurën e prokurimit për blerjen e 73 motoçikleta për Policinë Rrugore, me vlerë të kontratës së lidhur 111,427,200 lekë gjithsej (1,526,400 lekë/copa). Të dy kontratat janë realizuar duke blerë 195 motoçikleta gjithsej.

U verifikua nëse mjetet e blera janë vendosur në punë dhe u konstatua se 73 mjetet e blera për Policinë Rrugore gjatë vitit 2015 janë vendosur në përdorim plotësisht, kurse nga 122 mjetet e blera gjatë vitit 2014, u konstatua se të paktën 52 mjete, ose rreth 43 % me vlerë rreth 30,000 mijë lekë, janë përdorur shumë pak, ose aspak (deri 5,000 km në rreth 4 vjet).

Vlen të evidentohet se:

Në DVP Kukës, 4 motorë të dërguar, për periudhën prill 2015 deri gusht 2018 kanë kryer secili jo më shumë se 290 km gjithsej.

Në DV Gjirokastrë, një motoçikletë gjatë vitit 2016, 2017, 2018 (rreth tre vjet) ka kryer zero km, kurse dy mjete të tjera, për periudhën 2015-2018 (rreth tre vjet) kanë kryer rreth 700 km/secili etj.

Në DV Durrës, pesë motoçikleta në vitin 2017 – 2018 dhe katër të tjera në vitin 2016 – 2018 kanë kryer zero km gjithsej.

Në DV Elbasan, katër motoçikleta në vitin 2016 – 2018 kanë kryer zero km gjithsej.

Në DV Tropojë, një mjet për periudhën 2015 - 2018 ka kryer zero km etj.

Për 52 mjetet që janë përdorur pak ose aspak, janë paguar sigurimet me vlerë mesatare rreth 10,380 lekë/mjeti, ose 539,760 lekë gjithsej.

Vlera 30,540 mijë lekë (30,000 mijë lekë për motorë të cilët janë përdorur pak ose aspak dhe 540 mijë lekë për sigurimin e motorëve) nën arsyetimin si më lart, përbën përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve.

C.2 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatohet se ish Drejtori i Përgjithshëm, i ka hapur rrugën e marrjes së gradave më të larta nga punonjësit e policisë pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit, nëpërmjet emërimeve të punonjësve të policisë me gradë më të ulët, në funksione më të larta.

Punonjësi i policisë, që të ngrihet në funksion, duhet të ketë gradën përkatëse, e cila fitohet vetëm me konkurrim. Për një gradë mund të konkurrojnë disa dhjetëra punonjës policie.

Ish Drejtori i Përgjithshëm i DPPSH, ka vepruar duke emëruar në funksion/funksione punonjës policie me gradë më të ulët.

Me marrjen e funksionit, punonjësi i policisë i është drejtuar gjykatës/gjykatave, duke kërkuar/fituar, gradën më të lartë.

Në tërësi, praktika e ndjekur nga DPPSH, është në kundërshtim me:

- nenin 50/2 të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 në të cilin është përcaktuar se” ... *Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit,*

- nenin 53/2 “Dhënia e gradës” të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 grada “Nënkomisar” deri “Drejtues i parë” jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji”, dhe

- nenin 54 në të cilin është përcaktuar se “... Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi”.

Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse.”

Nga të dhënat e Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, rezultojnë se janë rreth 225 punonjës policie (kryesisht pas vitit 2014) që kanë ndjekur këtë procedurë, nga të cilët, pas verifikimit rezulton se 100 prej tyre e kanë fituar gradën/gradat me vendim gjykate, 112 padi janë në proces dhe 13 janë pushuar, ose rrëzuar (shih listën nr. 4 bashkëngjitur).

U verifikuan dosjet e 45 punonjësve të policisë që kanë fituar gradën me vendim gjykate gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, nëse plotësonin kriteret për t’u ngritur në funksion në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 dhe rezultoi se 16 prej tyre të përzgjedhur nga ish titullari i DPPSH, nuk kanë plotësuar kriteret për ngritje në funksion (gradë).

Në 32 raste, me shënim të Titullarit, DPPSH, nuk është përfaqësuar në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke sjellë si pasojë që vendimet të marrin formë të prerë që në shkallën e parë.

Sa më sipër, bie ndesh me nenin 452 K.Pr.C. në të cilin është përcaktuar se “*Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj”, nen i cili nuk përjashton DPP të mos ushtrojë të drejtën ankimit ndaj vendimeve gjyqësore për aq kohë sa, këto vendime sjellin pasoja financiare në buxhetin e institucionit.*

Nën këtë arsyetim, referuar pikës 62 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 2, date 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” përcaktohet qartë se “*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësi administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuידohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi*”, Titullari duhet të kishte autorizuar ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët gjyqësore.

Për sa sipër, për të gjitha vendimet gjyqësore ku DPPSH ka humbur dhe që nuk janë ankimuar në Apel, nga Titullari duhet të ishin analizuar duke nxjerrë përgjegjësitë administrative të mos ndjekjes së këtyre ankimeve.

Efekti i financiar i veprimeve të kundërligjshme të cituar më lart është rreth 25,000 mijë lekë, i cili nën arsyetimet e mësipërme, përbën shpenzim me efekt negativ për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi z. H. Ç, në cilësinë e ish Drejtorit të DPPSH në atë kohë.

D. MASA DISIPLINORE

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të rikërkojë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë, të fillojnë procedurat disiplinore për:

1. Z. E. P, Gjuqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për të njëjtat arsye të kërkuara në shkresën nr. 5536/2, datë 28.8.2017 të DPPSH-së.

2. Z. E. M, Gjuqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, pasi të paktën në dy vendime për vitin 2017, ka dhënë gradën K/komisar, një gradë më lart për z. F.R dhe gradën K/komisar, pra njëherësh dy grada më lart për z.H. M, në kundërshtim me nenin 54, 55 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” etj.

F. PËRCJELLJE PËR DIJENI DHE VLERËSIM

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatohet se ish Drejtori i Përgjithshëm, i ka “hapur rrugën” e marrjes së gradave më të larta nga punonjësit e policisë pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit, nëpërmjet emërimeve të punonjësve të policisë me gradë më të ulët, në funksione më të larta.

Punonjësi i policisë, që të ngrihet në funksion, duhet të ketë gradën përkatëse, e cila fitohet vetëm me konkurrim. Për një gradë mund të konkurrojnë disa dhjetëra punonjës policie.

Ish Drejtori i Përgjithshëm i DPPSH, ka vepruar duke emëruar në funksion/funksione punonjës policie me gradë më të ulët.

Me marrjen e funksionit, punonjësi i policisë i është drejtuar gjykatës/gjykatave, duke kërkuar/fituar, gradën më të lartë.

Në tërësi, praktika e ndjekur nga DPPSH, është në kundërshtim me:

- nenin 50/2 të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 në të cilin është përcaktuar se” ... *Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit,*

- nenin 53/2 "Dhënia e gradës" të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 grada "Nënkomisar" deri "Drejtues i parë" jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji", dhe

- nenin 54 në të cilin është përcaktuar se "... Fitimi i gradës "Nënkomisar" deri në "Drejtues i parë" bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi".

Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse."

Nga të dhënat e Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, rezultojnë se janë rreth 225 punonjës policie (kryesisht pas vitit 2014) që kanë ndjekur këtë procedurë, nga të cilët, pas verifikimit rezulton se 100 prej tyre e kanë fituar gradën/gradat me vendim gjykate, 112 padi janë në proces dhe 13 janë pushuar, ose rrëzuar (shih listën nr. 4 bashkëngjitur).

U verifikuan dosjet e 45 punonjësve të policisë që kanë fituar gradën me vendim gjykate gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, nëse plotësonin kriteret për t'u ngritur në funksion në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 dhe rezultoi se 16 prej tyre të përzgjedhur nga ish titullari i DPPSH, nuk kanë plotësuar kriteret për ngritje në funksion (gradë).

Në 32 raste, me shënim të Titullarit, DPPSH, nuk është përfaqësuar në të gjitha shkallët e gjykimit, duke sjellë si pasojë që vendimet të marrin formë të prerë që në shkallën e parë.

Sa më sipër, bie ndesh me nenin 452 K.Pr.C. në të cilin është përcaktuar se "Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj", nen i cili nuk përjashton DPP të mos ushtrojë të drejtën ankimit ndaj vendimeve gjyqësore për aq kohë sa, këto vendime sjellin pasoja financiare në buxhetin e institucionit.

Nën këtë arsyetim, referuar pikës 62 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 2, date 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" përcaktohet qartë se "Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi", Titullari duhet të kishte autorizuar ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët gjykimit.

Për sa sipër, për të gjitha vendimet gjyqësore ku DPPSH ka humbur dhe që nuk janë ankimuar në Apel, nga Titullari duhet të ishin analizuar duke nxjerrë përgjegjësitë administrative të mos ndjekjes së këtyre ankimeve.

Efekti i financiar i veprimeve të kundërligjshme të cituar më lart është rreth 25,000 mijë lekë, i cili nën arsyetimet e mësipërme, përbën shpenzim me efekt negativ për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi z. H.Ç, në cilësinë e ish Drejtorit të DPPSH në atë kohë.

Bazuar në faktin se praktika e ndjekur në shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullativ repsektiv, në mënyrë sistematike gjatë periudhës objekt auditimi.

Thyerja e proceseve dhe devijimet janë materiale për nga përmbajtja, si dhe ka rrezikshmëri që kjo praktikë të përdoret për periudhat vijuese.

Për këto arsye, Raporti Përfundimtar i Auditimit t'i përcillet zyrtarisht Institucionit të Prokurorisë për vlerësim në lidhje me ekzistencën ose jo të veprës penale të mundshme të ish Drejtorit të Përgjithshëm, për praktikën e marrjes së gradave më të larta nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pa ju nënshtruar procedurës së konkurrimit, nëpërmjet emërimeve të punonjësve të policisë me gradë më të ulët, në funksione më të larta.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R